



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

RAPORTI I VLERËSIMIT TË DIPLOMUARVE TË UNIVERSITETIT "KADRI ZEKA" NGA PUNËDHËNËSIT

Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi

Fitore Malaj-Abdyli

Përmbajtja

Hyrje	3
1. Metodologjia e hulumtimit	4
1.1. Qëllimi i hulumtimit	4
1.2. Metodatat e hulumtimit.....	4
2. Rezultatet e Hulumtimit	5
2.1. Informata për rrjedhën e hulumtimit.....	5
2.2. Analiza e pyetësorëve	6
2.2.1. Rezultatet e vlerësimit të diplomuarve të UKZ-së nga punëdhënësit	
3. Përfundime dhe rekomandime.....	15

Hyrje

Duke u bazuar në Rregulloren për e Sigurimin e Cilësisë, Këshilli Mbikëqyrës i Cilësisë dhe Vlerësimit ka vlerësuar që është e nevojshme të realizohet një hulumtim me punëdhënësit lidhur me të diplomuarit e UKZ, me qëllim që të bëjmë rishikimet e nevojshme për të përgatitur sa më shumë kuadro të përshtatshme për tregun e punës. .

Në kuadër të kësaj kemi hartuar pyetësin të bazuar në programet të cilat u ofrohen studentëve, njohuritë dhe shkathtësitë që kanë fituar ata gjatë studimeve si në komunikim, punë kërkimore shkencore, punë ekipore ashtu edhe në njohuritë dhe përdorimin e gjuhës angleze dhe teknologjisë informative.

Me anë të pyetësorëve ne kemi bërë vlerësimin e cilësisë së studentëve tanë nga këndvështrimi i Punëdhënësve..

1. Metodologjia e hulumtimit

1.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me konkurrencën e të diplomuarve UKZ-së, në tregun e punës poashtu cilësinë e studimeve që ofrojnë programet studimore te Universitetit Kadri Zeka për studentët që studiojnë dhe diplomojnë në këtë universitet.

Nga ky hulumtim kemi arritur të nxjerrim vlera të cilat identifikojnë shkallën e veprimit të diplomuarve në tregun e punës brenda angazhimit të tyre në sektorë të ndryshëm të punësimit.

Rekomandimet e dala nga ky vlerësim do t'u shërbejnë Njësive Akademike për të reflektuar lidhur me përmisimet në zhvillimin e programeve të tyre.

1.2. Metodatat e hulumtimit

Hulumtimi u realizua kryesisht përmes metodës kuantitative dhe instrumenteve që janë në funksion të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Shpërndarja e pyetësorëve u realizua drejtpërdrejtë përmes Google Forms.

Meqenëse objekt hulumtimi ishin studentët tanë të diplomuar në tregun e punës (sektori privat dhe sektori publik) Shpërndarja e pyetësorit u bë në përgjegjësit e caktuar të ndërmarjeve private dhe publike në regjionin tonë..

Pyetësori qëndroi i hapur për plotësim një javë.

2. Rezultatet e Hulumtimit

2.1. Informata për rrjedhën e hulumtimit

Duke u bazuar në Rregulloren për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësimit tek neni 5 ku përcaktohen instrumentet për vlerësim të brendshëm të cilësisë është paraparë që përveç vlerësimit tjera , të bëhet edhe vlerësimi nga punëdhënësin, kështu që në bashkëpunim me Këshillin Mbikëqyrës i Cilësisë kemi hartuar pyetësozin sipas Shkallës së Likertit, ku për secilin konstatim është dashur të shprehur, me 5=Shumë i kënaqur; 4= I kënaqur; 3=Mesatarisht të kënaqur; 2=Pak të kënaqur; dhe 1=Aspak të kënaqur .

Për të realizuar hulumtimin është angazhuar Koordinatori për punë praktike me biznese si dhe koordinatori për praktikë mësimore të cilët kanë siguruar kontaktet dhe kanë bërë shpërndarjen e pyetësorëve tek 20 drejtorw tw shkollave fillore te komunave Gjilan, Kamenice, Viti, Kaçanik dhe Hani i Elezit.


Pas përpunimit të dhënave është përpiluar raporti, i cili do t'i dorëzohet Këshillit Mbikëqyrës të Cilësisë dhe Vlerësimit si dhe menaxhmentit të Fakultetit tw Edukimit.

Për hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit si dhe publikimin e rezultateve ka punuar kryesisht Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi

2.2. Analiza e pyetësorëve

2.2.1. Tw dhwnat demografike


Grafiku 1. Pjesëmarrja në vlerësim e drejtorwve tw shkollave sipas Komunave



Nw grafikun 1 është paraqitur pjesëmarrja e drejtorwve nw hulumtim sipas vendeve ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Siç shihet në përqindje më të lartë tw drejtorwve që i janë përgjigjur pyetësorëve janë nga qyteti i Gjilanit me 50%. 20% nga qyteti i Kamenicës, kurse me nga 10% janë përgjigjur punëdhënësit nga Kamenica, Kaqaniku dhe Hani i Elezit.


**Grafiku 2. Pjesëmarrja në vlerësim e punëdhënësve sipas gjinisë
Gjinia e të punësuarve**



Grafiku 2 tregon pjesëmarrjen e punëdhënësve sipas gjinisë. Në grafikon shihet se përfaqësues të kompanive dhe organizatave kryesisht janë meshkuj, rreth 70% prej tyre.

Përfshirja e femrave në krahasim me meshkuj është dukshëm më e ulët me 30%


**Grafiku 3. Rezultatet e vlerësimit të studentëve të punësuar sipas moshës
Mosha e të punësuarve**



Grafiku 3 paraqet moshën e të diplomuarve të punësuar. Siç shihet, të diplomuarit e punësuar në përqindje më të lartë janë të moshës 31-36 vjeç, rreth 40%. Të diplomuar të moshës 26-30 janë 30% kurse 20% janë të moshës 20-25. Me një përqindje të vogël janë të diplomuarit mbi moshën 36 vjet (10%)

Grafiku 4. Rezultatet e vlerësimit të numrit të studentëve të punësuar


Sa të diplomuar keni punësuar në pesë vitet e fundit nga UKZ-ja



Sipas grafikorit 4, rreth 90% e punëdhënësve deklarojnë se numri i të punësuarve është më së shumti 5 të punësuar. Kurse 10% e të anketuarve kanë të punësuar 10-15 të diplomuar.

Grafiku 5. Pozitat në të cilat punojnë të diplomuarit e UKZ-së


Pozitat e ofruara



Grafikoni 5 paraqet pozitat në të cilat më së shumti janë të angazhuar të punësuarit . Siç shihet rreth 40% e të punësuarve mbajnë pozita shërbyese, Pozita teknike dhe Administrative mbajnë 20%, të dy nga 20%. Pozitën në menxhim të lartë e mbulojnë rreth 10% , gjithashtu në pozita tjera kanë deklaruar 10%.

Grafiku 6. Punëdhënësit dhe kënaqësia e tyre me të punësuarit


A jeni të kënaqur me të diplomuarit e UKZ-së përgjithësisht?



Në grafikun 6 janë shprehur rezultatet në përqindje sipas vlerësimit që është bërë për kënaqshmërinë e punëdhënësve karshi të punësuarve të tyre. Siç shihet 50% janë shprehur të kënaqur duke u pajtuar plotësisht me pyetjen e bërë. 30% prej tyre janë pajtuar dhe 10% të tjerë janë pajtuar pak ose nuk janë pajtuar fare (10%).

Grafiku 7. Të punësuarit dhe përgatitja e tyre profesionale


A mendoni se planprogrami studimor i ka aftësuar të diplomuarit për vendin e tyre të punës?



Në pyetjen, A mendoni se planprogrami studimor i ka aftësuar të diplomuarit për vendin e tyre të punës? Siç shihet në grafikun 7 shumica e punëdhënësve mendojnë pozitivisht. Rreth 50% të tyre janë shprehur se pajtohen dhe 20% janë pajtuar plotësisht. 20% e punëdhënësve janë pajtuar mesatarisht në një përqindje të vogël prej 10% nuk janë pajtuar fare.

Grafiku 8. Të diplomuarit dhe nevojat e punës


A tregojnë aftësi të mjaftueshme të diplomuarit që të kuptojnë nevojat tuaja të punës?



Grafiku 8 shpreh rezultatet e pyetjes që ka të bëjë me zotërimin e aftësive të të diplomuarve lidhur me nevojat e punës, ku shumica e punëdhënësve janë shprehur mjaft të kënaqur me të punësuarit e tyre lidhur me kuptimin e nevojave të punës. Rreth 50% janë pajtuar kurse 30% janë pajtuar plotësisht. 10% janë shprehur neutral lidhur me konstatimin se zyrtaret u përgjigjen me korrektësi kërkesave të studentëve. Në përqindje më të ulët, punëdhënësit janë shprehur të pakënaqur apo nuk janë pajtuar fare 10%. Poashtu 10% të tyre janë pajtuar pak.

Grafiku 9 dhe pyetjet e hapura: Të punësuarit dhe zhvillimi profesional i tyre

A ofroni trajnime shtesë për të diplomuarit me rastin e punësimit të tyre? Nëse po, a janë këto trajnime: Specifike (Ju lutem shpjegoni arsyen pse janë specifike); Të përgjithshme (Ju lutem shpjegoni arsyen pse janë të përgjithshme); Tjetër (Ju lutem shpjegoni arsyet).



Në grafikun 9 kemi rezultatet e vlerësimit të pyetjes së nëntë, lidhur me trajnimet që u ofrojnë punëdhënësi të diplomuare me rastin e punësimit .

Sipas këtyre rezultateve rreth 80% e të anketuarve janë shprehur se organizojnë trajnime, kurse 20% prej tyreve kanë thënë që nuk organizojnë trajnime.

Responentët tanë përmes pyetjeve të hapura kanë treguar se si i organizojnë këto trajnime

ne fusha te caktuara

Nuk ofrojme trajnime!

Jo

Specifike per shkak te industrise qe neve veprojme dhe sherbimit qe ofrojme .

Pershkrim Pune, Njoftim me Punen

Varesisht nga pozita ne bejme edhe trajnime shtese dhe keto trajnime zgjasin 3 muaj ne menyre qe i punesuari te jete i gatshem per pune.

Trajnime ne programin e doganes

ndihmojne ne arritjen e objektivave

Strateiine e Kompanise. taraetet. sistemet kompiuterike qe i perdor kompania eti

Të diplomuarit dhe shkathtësitë e tyre

Cilat lëndë apo aftësi, shkathtësi dhe kompetenca rekomandoni të shtohen në programin e studimit që të diplomuarit të jenë më të përgatitur për të kryer me sukses detyrat e punës

Mendoj se duhet te lidhet teoria me praktiken per shumicen e lendeve te studimit!

Trajnime te ndryshme

export specialist

Puna Praktike

Eshte nevojë e kohes qe studenteve te i ipet mundesia te mbajne pune praktike neper kompani te ndryshme sepse shumica e studenteve qe i punesojme deklarohen qe nuk kane ndonje pervoje te tille.

Mendoje qe duhen te bejn sa me shume pune praktike

mjekesi



Inovacioni dhe nderrmarresia

Inxhinieri

Në pyetjet e hapura lidhur me aftësitë, shkathtësitë dhe kompetencat në të cilat duhet të zhvillohen programet e studimeve ne UKZ. Punëdhënësit në numër të madh kërkojnë që sa më shumë të rritet puna praktike gjatë studimeve, studentët të kenë mundësi të marrin pjesë në trajnime, gjithashtu kërkojnë që programet e UKZ të zhvillohen në ingjineri , mjeksi si dhe inovacione dhe ndërrmarësi


Grafiku 10. Të diplomuarit dhe të menduarit kritik dhe analitik

Grafiku 11. Të diplomuarit dhe njohuritë specifike për vendin e punës




Lidhur me të menduarit kritik dhe analitik të diplomuarve si dhe njohuritë specifike për vendin e punës, punëdhënësit janë shprehur të kënaqur, 40 % prej tyre, mesatarisht të kënaqur 30 %. Shumë të kënaqur 20 %, kurse pak të kënaqur janë shprehur 10% të të anketuarve. Sipas këtyre të dhënave shihet se punëdhënësit kryesisht janë të kënaqur me të menduarit kritik dhe analitik të diplomuarve tanë si dhe njohuritë të cilat i posedojnë ata.

Grafiku 12. Të diplomuarit dhe aftësia e tyre për zgjedhje të problemeve




Në Aftësitë e të diplomuarve për zgjidhjen e problemeve në një përqindje të kënaqshme me rreth 50% punëdhënësit shprehen shumë të kënaqur, të kënaqur 40%, kurse 10% e tyre shprehen më pak të kënaqur.

Grafiku 13. Të diplomuarit dhe aftësitë e tyre për punë kërkimore dhe hulumtuese




Në grafikun 13 është shprehur përqindja e kënaqshmërisë së punëdhënësit karshi aftësive të të diplomuarve për punë kërkimore dhe hulumtuese. Siç shihet rreth 40% janë mesatarisht të kënaqur, 30% shumë të kënaqur kurse 20% pak të kënaqur dhe 10% të kënaqur.

Grafiku 14. Të diplomuarit dhe njohuritë e tyre në mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave




Të dhënat në grafikun 14 lidhur me njohuritë e të diplomuarve në mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave na tregojnë se 30% e të anketuarve shprehen shumë të kënaqur, poashtu 30% prej tyre janë të kënaqur, kurse me një përqindje më të ulët janë të anketuarit që janë mesatarisht të kënaqur (20%) dhe pak të kënaqur (20%).

Grafiku 15. Të diplomuarit dhe aftësitë komunikuese, komunikimin verbal dhe me shkrim




Në aftësitë komunikuese të diplomuarve në komunikimin verbal dhe me shkrim punëdhënësit shprehen në një përqindje të lartë të kënaqur (50%), Shume të kënaqur shprehen rreth 40%. Në një përqindje të ulët rreth 10 % të punëdhënësve janë shprehur aspak të kënaqur në aftësitë komunikuese.

Grafiku 16. Të diplomuarit dhe Njohuritë dhe përdorimin e gjuhës angleze




Përdorimi i gjuhës angleze tek të diplomuarit e UKZ-së nga punëdhënësit vlerësohet pjesërisht kënaqshëm. Sipas grafikorit shohim se 40% e të anketuarve janë të kënaqur. 20% prej tyre mesatarisht të kënaqur, kurse 20% të tjerë janë shprehur shumë të kënaqur. Derisa 10% të anketuarve shprehen më pak të kënaqur si dhe 10% të tjerë aspak të kënaqur me përdorimin e gjuhës angleze nga të diplomuarit.

Grafiku 17. Të diplomuarit dhe Njohuritë për përdorimin e Teknologjisë informative




Grafiku 17 përmban të dhënat për njohuritë e të diplomuarve në përdorimin e teknologjisë informative. Siç shihet lidhur me këtë aspekt 50% e punëdhënësve janë shumë të kënaqur me të punësuarit e tyre. 30% prej tyre janë mesatarisht të kënaqur, kurse 20% tjerë janë të kënaqur.

Grafiku 18. Të diplomuarit dhe puna ekipore dhe nën presion të kohës




Të diplomuar dhe aftësitë e tyre për punë ekipore dhe nën presion të kohës është vlerësuar nga punëdhënësit me një përqindje të kënaqshme. Në këtë çështje janë shprehur 30% shumë të kënaqur, 40% të kënaqur, dhe 30 % prej tyre shprehen mesatarisht të kënaqur.

Grafiku 19. Të diplomuarit dhe Sjellja etike dhe vlerat morale



Lidhur me sjelljen etike dhe vlerat morale të diplomuarve , punëdhënësit shprehen shumë të kënaqur me 50%. Lidhur me këtë rreth 30% shprehen të kënaqur dhe 20 % prej të anketuarve janë mesatarisht të kënaqur.

Grafiku 20 . Të diplomuarit dhe kontributi i tyre në organizatën tuaj



Grafiku 20 përmban të dhënat e shprehjes së kënaqëssë së punëdhënësit lidhur me kontributin e të diplomuarve në organizatat e tyre.

Në këtë aspekt rreth 50% e punëdhënësve janë shumë të kënaqur. 20% prej tyre janë të kënaqur, me një përqindje të njëjtë janë shprehur mesatarisht të kënaqur, kurse 10% shprehen më pak të kënaqur.

Në hapësirën koment i përgjithshëm nga punëdhënësi, të anketuarit janë shprehur të kënaqur me studimet që ofrohen në UKZ, gjithashtu shprehin gatishmëri për bashkëpunim në përmisime të vazhdueshme në favor të zhvillimit të Universitetit.

Jemi te kenaqur me angazhimin te diplomuarve tuaj

Asnjë koment!

Nuk kam ndonje koment

pergjithsisht ka vend per permirsime , po besoj qe sebashku mund te bejm ndryshime ne favor te perbashket.

Pergjithesisht, te kenaqur.

Punë të mbarë dhe suksese në edukimin e brezave te ardhshëm!

Mendoj qe duhet te kete sa me shume pune praktike se sa teorike

veq perpara me suksese te metutjeshme

Nuk kam koment

2.Përfundimet dhe rekomandimet

Duke u bazuar në të dhënat e këtij hulumtimi si dhe analizën e përgjithshme të rezultateve mund të konkludojmë se punëdhënësit, në një masë relativisht të lartë janë të kënaqur me të diplomuarit e universitetit “ Kadri Zeka” si dhe me përgatitjen e tyre për tregun e punës .

Siç shihet, qëndrimet e punëdhënësve të shprehura ndaj të diplomuarve, nga të gjithë palët e jashtme të interesit, shprehen të kënaqur më të diplomuarit tanë në e UKZ-së, Qëndrimet e tyre pothuajse janë të përafërta me ndonjë dallim të vogël në përqindje. Sipas rezultateve, të diplomuarit janë kryesisht të përgatitur për tregun e punës, si në komunikim, aftësi në zgjedhjen e problemeve, njohuritë në gjuhë angleze si dhe njohuri për përdorimin e teknologjisë.

Ku në të gjitha qëndrimet shprehen të kënaqur. Më pak kënaqësi vërhehet tek aftësitë e të diplomuarve për punë kërkimore hulumtuese si dhe mendimi kritik dhe analitik i studentëve të diplomuar në UKZ.

Nga rezultatet e dala nga ky hulumtim mund të konkludojmë se programet studimore të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan ofrojnë studime të cilat premtojnë për të ardhmen Studentëve të diplomuar, ditë e më shumë, njohuritë e fituara gjatë studimeve të tyre po u ndihmojnë të punësohen dhe të ushtrojnë profesionin e tyre. Gjithashtu nga këto rezultate dolën edhe sygjerime të cilat duhet të shërbejnë për përmisime në planifikimet e ardhshme të UKZ-së.

Prandaj rekomandimet tona janë:

- Studentëve tu jepet mundësia që sa më shumë të kenë praktikë gjatë studimeve të tyre.
- Të forcohet mësimdhënia me studentin në qendër lidhur me nxitjen e zhvillimit të mendimit kritik dhe analitik tek studentët
- Mësimdhënia në UKZ të organizohet në grupe dhe punë ekipore
- Të zhvillohen lëndët e Teknologjisë Informative dhe gjuhët e huaja në të gjitha programet studimore në UKZ.
- Të punohet në rritjen e universitetit me fakultete të reja dhe programe tjera studimore krahas zhvillimeve të tregut të punës.

- Të organizohen trajnime për zyrtarëve për shërbime me studentë nga stafi administrativ lidhur me etikën e punës.
- Dekanët e NJA, të bëjnë një orar të rregullt për takim me studentët të cilët kanë nevojë t'i kontaktojnë.
- Të ketë mbikqyrje të rregullt me qëllim të ngritjes së nivelit të mirëmbajtjes së pastërtisë në hapësirat e UKZ-së
- Të rritet bashkëpunimi i zyrtarëve nga Administrata me studentët e UKZ-së.